

Në bazë të nenit 57 paragrafi 1 pika 2 dhe nenit 108 të Ligjit për Arsim të Lartë ("Gazeta Zyrtare" nr. 35/08, 103/08, 26/09, 83/09, 99/09, 115/10, 17/10, 51/11, 123/12, 15/13, 24/13, 41/14, 116/14, 130/14, 10/15, 20/15, 98/15, 145/15, 154 / 15 30/16 dhe 120/16) dhe Statutit të Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup, Rektorati i Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup, shpall:

KONKURS

për mësimdhënësit në të gjithë titujt arsimoro-shkencor dhe bashkëpunëtorë (asistent - doktorant) në Fakultetin e Shkencave të Informatike në përbërje të Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup

A. Shpallet konkurs për zgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha titujt arsimoro –shkencor dhe bashkëpunëtorë (asistentë - doktorant) në Fakultetin e Shkencave Informatike në përbërje të Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup.

Programi studimor: INFORMATIKË-MËSIMDHËNIE

1 .Një mësimdhënës nga drejtimi arsimor –shkencore GJUHË PROGRAMORE DHE TEKNOLOGJI (21201 nga klasifikimi i lëmive hulumtimito-shkencore, fushave dhe lëmive sipas Klasifikimit të Fraskativës)

2.Një mësimdhënës nga drejtimi arsimor –shkencore BAZA E TË DHËNAVE (21203 nga klasifikimi i lëmive hulumtimito-shkencore, fushave dhe lëmive sipas Klasifikimit të Fraskativës)

B. Kandidatët e interesuar duhet t'i plotësojnë kushtet për zgjedhje në thirrje arsimoro – shkencore, respektivisht në thirrje për bashkëpunëtorëve (asistentë - doktorant) të përcaktuara me Ligjin për Arsimin e Lartë.

C. Kandidatët për thirrje arsimoro - shkencore duhet t'i dorëzojnë dokumentet që vijojnë:

- Kërkesë për aplikim;
- Diploma e marrjes së titullit shkencor Doktor i shkencave të lëmisë shkencore në të cilën zgjedhet (një ekzemplar i diplomës i notarizuar dhe tri kopje; diplomat e fituara jashtë vendit të jenë të nostrifikuara dhe të jenë me ekuivalencë të notave);
- Biografi të shkurtë (në tri kopje);
- Lista e punimeve të publikuara shkencore (një kopje e punimeve);
- Një kopje e punës të doktoraturës;
- Certifikata e shtetësisë së Republikës së Maqedonisë.

D. Kandidatët për titullin bashkëpunëtorë (asistent - doktorant) duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Fletëparaqitje;
- Diploma e marrjes së titullit shkencor Magjistër nga lëmia shkencore në të cilën zgjedhet (një ekzemplar i diplomës i notarizuar dhe tri kopje; diplomat e fituara jashtë vendit të jenë të nostrifikuara dhe të jenë me ekuivalencë të notave);

- Biografi të shkurtë (në tri kopje);
- Lista e punimeve të publikimeve shkencore (një kopje e punimeve), në qoftë se i posedojnë;
- Dëshmi për njohjen e gjuhës angleze, edhe ate: (TOEFEL) - më së paku 74 pikë për dhënien elektronike të provimit përmes kompjuterit, jo më të vjetër se dy vjet nga data e lëshimit, (IELTS) – më së paku 6 pikë, jo më i vjetër se dy vjet nga data e lëshimit, (TOLES) - njohuri bazike (Foundation level), (ILEC) – e kryer me së paku me sukses B2 dhe Certifikatë të Kembrixhit për anglishten preliminare (Certifikate of Preliminary English)(B1);
- Certifikata e shtetësisë së Republikës së Maqedonisë.

D. Për kandidatët të cilët do të paraqiten për t'u zgjedhur për thirrjen arsimoro - shkencor docent, përveç dokumenteve të theksuara më sipër, duhet të paraqesin edhe dëshmi se kanë arritur notë mesatare e më së paku 8.00 për çdo cikël veçmas.

E. Për kandidatët të cilët do të paraqiten për zgjedhje në thirrje bashkëpunëtorë (asistent – doktorant), përveç dokumenteve më sipër të përmendura, duhet të paraqesin edhe dëshmi se kanë arritur notë mesatare më së paku 8.50, në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve.

F. Konkursi zgjatë tetë ditë nga dita e shpalljes së konkursit.

F. Konkursi zgjat pesë ditë pune pas shpalljes së konkursit. Fletëparaqitjen me dokumentet e nevojshme, kandidatët duhet t'i dorëzojnë në Universitetin "Nënë Tereza" në Shkup, rr."12 Brigada e Maqedonisë" nr. 2-a /kati VII (me shënimin: Konkurs për mësimdhënësit në të gjithë titujt arsimoro-shkencor dhe bashkëpunëtorë (asistent - doktorant) në Fakultetin e Shkencave të Informatike në përbërje të Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup.